

Përgatitja për takimin për vaksinimin kundër COVID-19



Çfarë duhet ditur para se të shkoni

- Vaksina është falas për të gjithë.
- Duhet të lini takim për të bërë vaksinën.
- Vaksinat Pfizer dhe Moderna kërkojnë dy doza. Përpara se të lini takimin për dozën e parë, lini ose mësoni si të lini takimin për dozën e dytë po në të njëjtin vend.
- Vaksina Johnson & Johnson (Janssen) kërkon vetëm një dozë.
- Nuk ka nevojë të kini sigurimin shëndetësor, patentën, ose numrin e sigurimit social për të bërë vaksinën.

Çfarë ju duhet për takimin

Qendra juaj e vaksinimit mund të listojë dokumentet e mëposhtëm si të domosdoshëm, por megjithatë kjo është për ata që i kanë ato. Përsëri mund ta bëni vaksinën edhe kur nuk keni sigurimin ose ID.

- Një ID me emrin tuaj për të verifikuar emrin në sistemin e vaksinimit.
- Kartën e sigurimit shëndetësor. Sigurimi shëndetësor juaj do të faturohet pa asnjë kosto për ju.



Ruani të tjerët

Do të duhet kohë që të vaksinohen të gjithë kundër COVID-19. Vazhdoni të përdorni të gjitha mjetet për të ndaluar përhapjen – përpara vaksinës, midis dozave të vaksinës dhe kur vaksinoheni plotësisht.

Për të lënë takim, vizitoni mass.gov/COVIDvaccine

Rifreskuar më 29/04/2021

